



Народна банка
на Република Македонија



EUROPEAN FUND FOR SOUTH-EAST EUROPE
DEVELOPMENT FACILITY



Udhëzues
për
**EDUKIM
FINANCIAR**



Shtypi

E publikuar nga Projekti për zhvillim të EFSE (EFSE DF)
Koncepti, faqosja dhe litografia: EFSE DF e financuar nga
ana e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë
(BPRM) dhe Projektit për zhvillim të EFSE-së

© 2016 Projekti për zhvillimin e EFSE-së

Demant

Projekti për zhvillimin e EFSE DF me kujdes i
kontrollon informatat të përfshira në këtë dokument.
Sidoqoftë, Projekti për zhvillimin e EFSE DF nuk merr
asnjë përgjegjësi dhe nuk garanton për afatin kohor,
saktësinë dhe tërësinë e informatave të parashikuara
në këtë dokument.

TUNGJATJETA, SHOK I DASHUR!

Paratë janë një pjesë e rëndësishme e jetës së përditshme. Por menaxhimi i parave mund të jetë një detyrë shumë e vështirë. Disa here prindërit, shokët, kolegët ankohen për mungesën e parave. Nëse shuma e parave që posedoni nuk është e mjaftueshme atëherë ju jeni në telashe, mirëpo edhe posedimi i një shume më të madhe të parave, nëse nuk dini si ti harxhoni, mund përsëri t'ju fusë në telashe.

Ky udhëzues do t'ju ndihmojë ti menaxhoni paratë tuaja me zgjuarsì. Pasi ta lexoni, do të mësoni:

- Çka janë paratë dhe nga vijnë ato?
- Si ti harxhoni paratë me përgjegjësi?
- Si ti menaxhoni të hyrat e juaja?
- Cilat janë përparësitë e kursimit?
- Çka është buxheti?



Fjalorthi:

Banka – Institucion financiar i autorizuar të pranojë depozita, paguaj interes, japë kredi, të veprojë si ndërmjetësues në transaksionet financiare dhe sigurojë shërbime tjera financiare për konsumatorët.

Paratë – mjet me anë të së cilit matet vlera e mallrave dhe shërbimeve dhe shprehet çmimi i tyre. Me ndërmjetësim të parave kryhet këmbimi. Si mjet për pagesë, ato kryejnë funksionin e mjetit këmbyes d.m.th. ato kryejnë funksionin e ndërmjetësuesit në këmbimi. Këto janë dy funksionet themelore të parave (masë për vlerën dhe mjet këmbyes).

Kartela bankare – kartelë plastike që lëshohet nga banka me një shirit magnetik dhe çip të zgjuar „smart“ me kod identifikues. Kartelat bankare përdoren për tregti elektronike (me lexues të shiritit magnetik dhe çip të zgjuar „smart“ ose nëpërmjet të internetit) dhe për transaksione bankare nëpërmjet bankomatëve.

Shpenzimet – konsumimi i parave të gatshme „kesh“ për të plotësuar nevojat individuale.

Kredia – kontratë e shkruar ose gojore për transferim të përkohshëm të pronës (zakonisht para të gatshme „kesh“) nga pronari (ai që e jep kredinë) deri te huamarrësi i cili premton të kthejë atë në bazë të kushteve të marrëveshjes, zakonisht me interes për përdorimin e tij.

Kreditor – pala që e jep kredinë.

Debitor – pala e cila ka borxh kreditorit.

Depozita – mjete ose sende me vlerë të cilat u janë besuara institucioneve financiare. Bankat paguajnë interes për shumat e depozituara dhe pranojnë pagesa për ruajtjen e sendeve me vlerë.

Interesi – kompensim i paguar për përdorimin e parave të një pale tjetër. Për huamarrësin paraqet harxhim për marrjen e parave me qira, për huadhënësin paraqet përfitimi nga huadhënia e parave (kreditimi).

Përfitimi – teprica që mbet pasi hiqen shpenzimet në total nga të ardhurat në total të llogaritura për një periudhë të caktuar kohore.

Të ardhura – rrjedha e parave të gatshme ose ekuivalentet e parave të gatshme të pranuar nga puna (pagë), kapitali (interes ose përfitim) dhe kreditimit (huadhënies).

A e dini se...

Paratë, si mjet për pagesë, janë përdorur që nga kohët antike të civilizimit njerëzor! Janë përdorur nga fillimi i marrëdhënieve tregtare si mjet për pagesë në formën e monedhave, që më vonë të zëvendësohen me kartëmonedha dhe mjete elektronike për pagesë.

Çka do të thotë **kursim** dhe si mund të **kursejmë** para?

Mund të ballafaqoheni me disa situata:

Të ardhurat > Shpenzimet = + (KURSIM)

Të ardhurat < Shpenzimet = - (DEFICIT)

Të ardhurat = Shpenzimet = 0

Çka është kursimi? – Përdorim i zgjuar i parave ose burimeve tjera materiale; përfitim ose tepricë (të ardhurat tejkalojnë shpenzimet).

Paratë që ju fitoni mund të klasifikohen si vijon:

- para për shpenzime të përditshme;
- para të kursyera për rrethana të paparashikuara; dhe
- para të kursyera për qëllime afatgjate.

„Paratë e kursyera janë para të fituara“

Këshilla për menaxhim të zgjuar të parave:

1. Fito para duke punuar.



- Puno për të fituar para.
- Shëndërroni pasionin tuaj për punë në një biznes të vogël. Nëse praktikoni hobi, si përpunimin e aksesorëve të modës, krijimin e faqeve të internetit, pikturimin, ju mund shumë lehtë ti shëndërroni këto në një biznes të vogël. Por fillimisht konsultoheni me prindërit tuaj në lidhje me punën që ju jeni të gatshëm ta bëni.
- Sa më shumë që punoni, aq më të mëdha janë mundësitë për të fituar.
- Kërkoni mundësi të ndryshme për të fituar para në mënyrë të sigurtë.
- Kini kujdes dhe shmangeni mundësitë për fitim ilegal të parave.



2. Përdorni paratë me përgjegjësi.


- Mos blini gjëra që nuk mund ti paguani dhe për të cilat nuk keni nevojë. Blini vetëm gjëra që ju duhen në të vërtetë.
- Blini me një listë të produkteve që në të vërtetë ju duhen dhe dëshironi ti blini.

- Krahasoni çmimet para se të blini diçka.
- Mos bini pre e promovimeve dhe lirimeve për shërbime ose produkte për të cilat nuk keni nevojë.
- Mos bini pre e videove promovuese në television ose internet.
- Me kohë llogaritni çmimin e prodhimeve që ju blini me qëllim që të jeni të sigurt se keni para të mjaftueshme për të paguar.
- Kontrolloni kusurin që e pranoni nga shitësi.
- Kërkoni llogarinë dhe ruajeni atë.
- Mos huazo para nëse nuk do të jeni të aftë ti ktheni ato.
- Ndani fitimet tuaja me miqtë tuaj të vërtetë të cilët kanë më pak se ju, edhe ato që kanë vështirësi financiare.



3. Kurseni sa më shumë.

- Vëndoni para anësh për rrethana të paparashikueshme.
- Mendoni për prodhime më të nevojshme që do të duhet ti blini dhe filloni të kurseni për këtë qëllim.
- Hartoni buxhetin tuaj personal.
- Analizoni shpenzimet e panevojshme që keni pasur në të kaluarën dhe mësoni nga gabimet tuaja.
- Bëni ose blini një kuti në të cilën do të kurseni para.




4. Ruani paratë tuaj në vend të sigurt.



- Ruani vlerat e mëdha të parave në llogari bankare, dhe jo nën jastëk ose vende tjera të pasigurta në shtëpinë tuaj.
- Shoqëroni prindërit tuaj kur të shkojnë të paguajnë llogaritë ose të hapin llogari bankare që të mësoni prej tyre.
- Bëhuni të kujdesshëm kur të bëni transaksione në internet. Shmangeni blerjes nga faqe të pabesueshme të internetit.
- Mos i leni të dhënat personale në internet.
- Mësoni nga prindërit tuaj ose ndonjë zyrtarë të bankës se si të përdorni bankomatin.

5. Bëhuni të disiplinuar në aktivitetet tuaja financiare.



- Lexoni libra për të mësuar si të fitoni më shumë, si të kurseni më mirë dhe si të harxhoni paratë tuaja në mënyrë më efikase.
- Shmangeni shprehinë për të lënë përshtypje te njerëzit tjerë me paratë e juaja.
- Konsultoni familjen tuaj para se të merrni vendime të mëdha financiare.
- Mbaroni arsimim që ju bën të lumtur dhe që zhvillon potencialin tuaj për të fituar në mënyrë të sigurtë.
- Mos harroni: Koha është para!
- Paratë nuk duhet të bëhen qëllimi përfundimtar, as përfitimi i tyre nuk duhet të jetë prioriteti i vetëm në jetën tuaj. Gjithmonë mbani mend se ka gjëra më të rëndësishme në jetë si liria, dashuria, lumturia, familja dhe shoqëria.

A e dini se...

Valuta kombëtare e Republikës së Maqedonisë është Denari. Valuta kombëtare emrin e sajë e ka marrë sipas valutës antike romake me emrin e njëjtë „Denar“ (lat. Denarius). Kjo monedhë për herë të parë është prodhuar në vitin 211 p.e.s, dhe është përdorur edhe në tokën tonë në të kaluarën. Simboli i valutës është MKD, ndërsa shkurtesa den. (tre shkronjat e para të emrit).

FJALË E URTË:

*„Me para mund të blesh libër,
mirpo jo edhe dituri“*



Rekomandime për krijimin e buxhetit personal:

Buxheti personal është i dobishëm vetëm kur menaxhohet me kujdes.

Buxhet - të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e njerëzve, institucioneve, organizatave ose të shtetit për një periudhë të caktuar.

Buxheti nuk do të thotë koprraci por kontroll.

1. Vendosni qëllimet tuaja financiare

Ato duhet gjithmonë të jenë të realizueshme, specifike, të balancuare dhe mirë të definuara. Tani është momenti i duhur për të vendosur qëllime afatshkurtëra dhe afatgjata. Shkruani një listë me gjithçka që dëshironi të bëni.

Qëllime	
Afatgjata:	Afatshkurtëra:

Një listë e qëllimeve të mundëshme:

Qëllime afatgjata: për shembull blerja e një biçiklete, kompjuteri, ose regjistrimi në kurs për kompjuterë ose punëtori tjera, etj.

Qëllime afatshkurtëra: organizimi dhe manifestimi i një ditëlindjeje, blerja e lodrave, aksesuarëve etj.

Pasi të keni kompletuar listën, llogaritni shumën mujore që duhet të kurseni që të realizoni këto qëllime.

2. Llogaritni të ardhurat tuaja mujore

Përcaktoni sa janë të ardhurat tuaja mujore: konsideroni shumën e parave të cilat i keni përfituar në mënyra të ndryshme, para të fituara, dhurata, huamarrje dhe të ardhura tjera. Pastaj kalkuloni të ardhurat mujore në total.

3. Llogaritni shpenzimet tuaja mujore

Bëni një listë prej të gjitha shpenzimeve tuaja mujore: pajisje shkollore, zbavitje, ushqim, transport, telefon, bami-rësi, kredi.

4. Llogaritni dallimin midis të ardhurave dhe shpenzimeve.

Gjeni cila është shuma që mbetet pas zbritjes së shpenzimeve nga të ardhurat. Nëse rezultati është pozitiv kjo do të thotë se buxheti ka një suficit, nëse është negativ atëherë ka deficit.


Në rast deficit, dy fazat e para duhet të rishqyrtohen. Ju duhet ta përshtatni sjelljen tuaj financiare: ose të rritni të ardhurat tuaja ose të zvogëloni shpenzimet.

Vini re! Fleksibiliteti! Buxheti është vetëm një mjet. Përdoreni atë, por mos e lejo të ju shpijë në rrugë të gabuar. Nëse ju shpenzoni më pak në një-rën pjesë, ndaje tepri-cën në pjesën tjetër ose kurseni ato që të keni një rezultate më të mirë.

**Filloni të kurseni
rregullisht dhe bëhuni
më të pasur!**



Fjalëkryq:



-
1. Mund të jetë debitore ose kreditore...
 2. Vendi ku kryhet tregtia.
 3. Një pjesë e gjatë dhe e rrafshët mobiljesh mbi të cilën kryhet biznesi.
 4. Përfitimi që fitohet për para të dhëna borxh ose të investuara.
 5. Para, stoli, dokumente dhe objekte të vlefshme që ruhen më shpesh në bankë.
 6. Automat ku kryhen transaksionet bankare.
 7. Valuta kombëtare e Republikës së Maqedonisë.

A e dini se...

Më 26 prill 1992, u prezantua monedha kombëtare e Republikës së Maqedonisë - denari i Maqedonisë. Të nesërmen, më 27 prill u lëshuan në qarkullim kartëmonedhat („kuponët e vlefshëm”), ndërsa më 30 prill, Dinari i Jugosllavisë nuk ishte më mjet ligjor për pagesë. Në muajin maj të vitit 1993 u këmbye denari i parë me normë 100 ndaj 1, me denarë të ri dhe permanent në formën e kartëmonedhave dhe monedhave.

Pyetje:

Me cilën valutë të huaj ne paguajmë në vendet e eurozonës?¹



¹ Përgjigje: **euro**

10 fjali të urta dhe thënie për paratë:

1. „Mungesa e parave nuk është një pengesë, mungesa e ideve PO“. (Ken Hakuta)
2. „Gjërat më të çmuara në jetë nuk blihen me para.“ (Filip Nover)
3. „Suksesi nuk krijohet nga paratë por nga liria ti përfitosh ato.“ (Nelson Mandela)
4. „Biznes i cili bën vetëm para është biznes i varfër.“ (Henri Ford)
5. „Paratë e kursyera janë para të fituara.“ (Benjamin Frenklin)
6. „I varfër nuk është ai që ka pak por ai që kërkon shumë.“ (Lucius Anaeus Seneka)
7. „Paraja është një shërbëtor i mirë por një pronar i keq.“ (Thënie arabe)
8. „Me para mund të bleësh shtëpi por jo paqe dhe qetësi në të.“ (Thënie kineze)
9. „Me para mund të bleësh krevat por jo gjumë“ (Thënie kineze)
10. „Me para mund të blini një status, por jo një reputacion“ (Thënie kineze)

Detyrë:

Në cilin rast do kishit më shumë para:

- a) nëse fitoni një milion denarë sot, ose
- b) nëse keni 1 denarë sot dhe çdo ditë i dyfishoni paratë tuaja 20 ditë me rradhë?²

Zgjidhja:

Dita 1 – $1+1=2$

Dita 2 – $2+2=4$

Dita 3 – $4+4=8$

Dita 4 – vazhdoni vetë...

²Përgjigje: *me 1 denarë prej sot për 20 ditë, do të keni total 1.048.576 denarë që është për 48.576 herë më shumë se vetëm një milion sot.*

Redaktor i publikimit: Kristina Pavleska

Lektorim: Arian Limani

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент
Охридски", Скопје

336.741(02.053.2)(036)

UDHËZUES për edukim financiar. - Скопје : Народна банка
на Република Македонија, 2017. - 16 стр. : илустр. ; 21 см
Fjalorthi: стр. 4

ISBN 978-9989-107-37-5

а) Пари - Водичи за деца

COBISS.MK-ID 105479946



Dhuratë - arkë kursimi

